

Ndërhyrjet agronomike

Krasitja: Mbjajtja e ullirit pa krasitur do të krijojë një kurorë të lartë dhe të dendur brenda së cilës do të krijohen kushte shumë të mira për zhvillimin e syrit të palloit. Krasitjet e përvitshme, menjëherë pas vjeljes por edhe në muajt e mëvonshëm do të sigurojnë parametra normal të zhvillimit të ullirit, ajrim të mirë të kurorës, mungesë të lagështisë të zgjatur në gjethe.

Plehrimi i balancuar i ullirit me plehra kimike, organike, plehrimi i gjelbër janë faktorë të cilët ndikojnë ndjeshëm në qendrueshmërinë e bimës. Luftimi i barishteve të egra të cilat konkurojnë fort bimën e ullirit për lendët ushqyese dhe ujin në tokë, kërkon vlerësim të vazhdueshëm nga ana e ullishtarëve pasi ulet qendrueshmëria e bimës së ullirit.

Të mos abuzohet me thellësinë e plugimit të ullishtave pasi punimet që bëhen mbi 15 cm thellësi shkaktojnë dëme të ndjeshme të sistemit rrënjor duke nxitur kështu prekjet nga sëmundje të tjera që atakojnë ullirin nëpërmjet sistemit rrënjor.

Zgjedhja varietale

Përdorimi i varieteteve më pak të ndjeshëm influencën në mënyrë të dukshme në kontrollin e syrit të palloit. Megjithatë kjo është një zgjedhje aktualisht jo shumë e praktike ushqe, sepse kultivarët më pak të prekshëm mund të jenë edhe më pak të vlerësuar. Përveç kësaj ndjeshmëria e varietetit ndaj syrit të palloit është e influencuar shpesh edhe nga ambienti ku kultivohet.



Ndër kultivarët që dallohen për qëndrueshmëri ndaj syrit të palloit janë:

- Lecino, qëndrueshmëri të lartë
- Frantoio, qëndrueshmëri të mesme
- Kalinjot, qëndrueshmëri të ulët
- Arbequina, qëndrueshmëri të mesme
- Koroneiki, qëndrueshmëri të ulët
- Megaron, qëndrueshmëri të mesme
- KMB, qëndrueshmëri të ulët
- Kallamon, qëndrueshmëri të ulët
- UB Tiranës, të mesme

Distancat e mbjelljes

Distancat e mbjelljes së ullirit varietet që vlerësohen për qëndrueshmëri ndaj syrit të palloit pranojnë distanca të afërta duke siguruar mbi 400 bimë/Ha. Në kultivarë të



Olive trees have been cultivated for centuries in Mediterranean climates, including California's Central Valley (shown). New super-high-density hedgerow systems allow for mechanical harvesting, greatly reducing labor costs.

veçante siç është Arbequina numri i bimëve mund të shkojë deri në 1500 rrënjë/Ha. Ndërsa për kultivarët që karakterizohen nga një qëndrueshmëri më e ulët distancat e mbjelljes duhet të jenë të tilla që të sigurojnë jo më shumë se 400 rrënjë/Ha.

QENDRA E TRANSFERIMIT TE TEKNOLOGJIVE BUJQESORE VLORE

Syri i palloit (*Spiloea oleagina*. Cast)



Kjo fletë palosje është bërë me synim dhënien e njohurive të shkurtra rreth sëmundjes kyç të ullirit, syri i palloit e cila shkakton dëme shumë të mëdha në prodhimin e ullirit po qe se nuk vlerësohet në vazhdimësi nga kultivuesit e ullirit.

Mendim Baçaj

Cel.068 22 09 469

E-mail mendimbacaj@yahoo.com

Karakteristikat morfologjike

Kërpudha qëndron për një kohë të gjatë në shtresën e jashtme të epidermës së gjetes. Nga kolonitë dalin hifet që futen në kutikul dhe prodhojnë konidioforet e lira, njëqelizore. Patogjeni është prezent në të gjithë zonat e kultivimit të ullirit në vendin tonë. Në zonat me verë të lagët vërehet një përhapje më e madhe e sëmundjes. Sëmundja ka zhvillim më të madh në zonën e poshtme të kurorës dhe në ullishtat e pakrasitura.

Kërpudha paraqet zakonisht dy cikle/vit, një në vjeshtë dhe një në pranverë duke qënduar në gjethe gjatë gjithë periudhës. Gjatë dimrit kur temperaturat dhe lagështia e vazhdueshme të infeksionit. Periudha e inkubacionit mund të ndryshojë nga 15-20 ditë deri në disa muaj në varësi të kushteve klimatike.

Kur kushtet e temperaturës dhe lagështisë janë të favorshme (zakonisht fundi i verës dhe vjeshta) kërpudha ka një zhvillim aktiv, duke shfaqur simptoma të dukshme dhe duke prodhuar konide për infeksionet e reja.



Simptomatologjia

Simptomat e syrit të palloit paraqiten kryesisht mbi gjethe, por mund të preken edhe degëzat e reja njëvjeçare, bishtat e gjetheve dhe frutat. Në faqen e sipërme të gjetheve formohen njolla të vogla kafe, të rrumbullakta e të veçuara. Në pjesën e poshtme të gjetes, simptomat rrallë herë duken. Në degëzat e reja njëvjeçare, mund të paraqiten infeksione që shfaqen me njolla kafe. Në fruta sëmundja është prezente akoma më rrallë, ku formohen njolla të vogla të çrregullta, lehtësisht të futura dhe të mbuluara nga një floreshencë ori

Dëmtimet

Shkakton në gjethe, të cilat nëqoftë se preken bien para kohe. Bimët që pësojnë një rënie të parakohshme të gjetheve, zakonisht reduktojnë formimin e sythave lulorë, duke shkaktuar një rënie të prodhimit nga 20% deri në 100% dhe në rastet e prekjeve të rënda mund ta çojnë bimën deri në tharje të plotë.

Infeksionet e rralla në fruta mund të rezultojnë të dëmshme vetëm për ullinj të tavolinës dhe jo aq për ata me destinacion për vaj sepse është vërtetuar që nuk influencojnë në cilësinë e vajit.

Kontrolli i patogjenit

Syri i palloit është sëmundje që shkakton më shumë dëme dhe kërkon vëmendje të vazhdueshme nga ana e fermerit, kur kushtet klimatike favorizojnë zhvillimin e sëmundjes dhe çojnë në uljen e prodhimit.

Aplikimi i teknikave të parandalimit që në fillim dhe me një trajtim të mirë të ullishtes, bën të mundur shfrytëzimin e faktorëve natyral dhe agronomik në kufizimin e sëmundjes.



Përdorimi i kontrollit direkt me preparate kimike jep rezultate të mira. Para fillimit të trajtimeve duhet të bëhet diagnoza për përcaktimin e infeksioneve latente. Ndër faktorët që kontrollojnë këtë sëmundje janë:

- faktorët natyral kufizues (temperaturë, lagështi, armiqtë natyror) ;
- ndërhyrjet agronomike (krasitja);
- zgjedhja varietore;
- distancat e mbjelljes;

Faktorët natyral kufizues

Temperaturat mbi 25 gradë C. ose nën 5-10 gradë C. janë kufizuese për fillimin e infeksionit. Temperatura optimale për zhvillimin e infeksionit është 18-20 gradë C. Në vendin tonë temp. e larta kanë një efekt më të madh kufizues ndaj infeksionit, krahasimisht me ato të ulëta.



Lagështia e lartë afër ngopjes është e nevojshme për mbirjen e konideve. Deri më sot nuk njihen mikroorganizma antagonistë të syrit të palloit.

Kontrolli kimik

Trajtimi i parë duhet bërë gjatë muajit shkurt me një preparat me bazë bakri. Trajtimi i dytë bëhet në muajin shtator, kur dignoza paraprake ka evidentuar infeksione latente dhe kushte të favorshme për zhvillimin dhe përhapjen e sëmundjes. Trajtimi i dytë duhet bërë menjëherë mbas përfundimit të vjeljes me preparatin Nativo duke përdorur 0.20 kg/Ha në 500 litra ujë. Nativo është fungicid sistemi e kontakti me veprim preventiv, kurativ dhe çrrenjosës.

